

VENDIM
Nr. 65, datë 2.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Sandër Beci,	anëtar;

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 2.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 5 (Z) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Zyra e Përmbartimit Privat ARB” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori Alban Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Banka Kombëtare Tregtare sh.a., në mungesë.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Rihapja e procesit/ve gjyqësor/e referuar vendimeve nr. 34, datë 1.11.2021, nr. 57, datë 20.5.2022 dhe nr. 80, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese (individualisht identifikuar si vendimet nr. 34/2021, nr. 57/2022 dhe nr. 80/2024 dhe/ose bashkërisht vendimet e viteve 2021/2022/2004).

Shfuqizimi i vendimeve nr. 34, datë 1.11.2021, nr. 57, datë 20.5.2022 dhe nr. 80, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese dhe pranimi i kërkesës.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përjashtimin e procedurave të sipërpërmendura.

Konstatimi i statusit “viktimë” përgjatë procesit/eve gjyqësor/e, si pasojë dhe rrjedhojë direkte e shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar më ligj dhe afatit të arsyeshëm në përputhje me çështjen “Scordino kundër Italisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, pika 2, 42, 116, pika 1, shkronja “b”, 122 dhe 131, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13, 19 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71/c, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, shoqërisë “Zyra e Përmbartimit Privat ARB” sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. (*BKT*) dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (*KESH*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka lidhur kontratë shërbimi me KESH-in për ekzekutimin e vendimit “Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit” nr. 9031 akti, datë 13.9.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*urdhri i ekzekutimit*), për faturën tatimore të shitjes nr. 248/2012 dhe nr. 254/2012, e cila ka korrigjuar të parën. Në bazë të asaj kontrate kërkuesja ka filluar procedurën për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit në favor të KESH-it si kreditor me debitore shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a. Pas lajmërimit për ekzekutimin vullnetar të urdhrit të ekzekutimit, kërkuesja ka lëshuar urdhrin për vënien e sekuestros konservative drejtuar bankave të nivelit të dytë.

2. Kërkuesja ka pretenduar se BKT-ja nuk ka përmbushur urdhërimet e saj për debitimin e llogarisë së debitorit në atë bankë, me qëllim pengimin e zbatimit të urdhrit të ekzekutimit. Në këto kushte, në datën 28.5.2014, ajo ka paditur në gjykatë BKT-në, ndaj së cilës ka kërkuar shpërblim për dëmin pasuror e jopasuror të pësuar, për fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore përkatëse sipas normës Tribor njëditor të vendosur nga Banka e Shqipërisë, deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës. Kërkimin për dëmin pasuror kërkuesja e ka bazuar në moskontraktimet e mëtejshme të saj nga KESH-i dhe kompania tjetër e sistemit energjetik, Operatori i Sistemit të Transmetimit (*OST*).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3048, datë 15.4.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkueses, pasi nuk u vërtetua ekzistenca e ndonjë dëmi pasuror që t’i ketë ardhur asaj nga i padituri. Ajo gjykatë, ndër të tjera, ka arsyetuar se pretendimi për moslidhjen e kontratave të mëtejshme, në kushtet kur nuk është vërtetuar asnjëherë se ka ekzistuar një vullnet i tillë nga pala tjetër kontraktore, është i pabazuar në ligj dhe bie në kundërshtim me parimin e lirisë kontraktore.

4. Për ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 944, datë 21.4.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 20.5.2016, kërkuesja ka ushtruar rekurs. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11118-02028-00-2016, datë 15.6.2016.

5. Në datën 14.12.2020, kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Me shkresën nr. 3102/1 prot., datë 21.12.2020, “Kthim përgjigjeje për konstatim shkeljeje afati të arsyeshëm”, kancelari i Gjykatës së Lartë ka njoftuar kërkuesen se kërkesa e saj nuk ishte nënshkruar nga një avokat i pajisur me akt përfaqësimi, sipas nenit 474 të *KPC*-së dhe, në këto kushte, e ka kthyer atë pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse. Në datën 30.12.2020, kërkuesja ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë një kërkesë me të njëjtin objekt dhe përmbajtje si ajo e datës 14.12.2020, të nënshkruar si nga administratori i shoqërisë, ashtu edhe nga një avokat. Ajo kërkesë është regjistruar me nr. 7 regjistri dhe 30.12.2020, datë regjistrimi.

6. Në përgjigje të kërkesës për informacion të kërkueses, me shkresën nr. 1008/1 prot., datë 1.4.2021, të kancelarit të Gjykatës së Lartë, ajo është njoftuar se të dyja çështjet e saj ishin në fazën e studimit për t’u shqyrtuar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

7. Duke pretenduar se Gjykata e Lartë ishte në vonesë si për shqyrtimin e çështjes civile, ashtu edhe për shqyrtimin e kërkesës së saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, kërkuesja, në datën 21.4.2021, ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar: i. konstatimin e cenimit të aksesit nga një gjykatë e caktuar me ligj; ii. konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile, dhe shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm; iii. konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura (*kërkesa nr. I*).

8. Gjykata, me vendimin nr. 34, datë 1.11.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se nuk ka rezultuar që kërkuesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së

paditur, për të cilat pretendon se kanë shkaktuar moslidhjen në vijimësi të kontratave të mëtejshme të shërbimit me shoqëritë KESH dhe OST. Në përfundim, Gjykata ka vlerësuar se edhe pse duket se deri diku ka një tejzgjatje të procesit, duke konsideruar rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuësës, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t'u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

9. Pas hyrjes në fuqi të vendimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 7, datë 16.12.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të paraqitur nga kërkuësja, duke argumentuar, ndër të tjera, se tejkalimi i afatit ligjor për shqyrtimin e rekursit të saj është rrjedhojë e disa rrethanave që përbëjnë pamundësi objektive.

10. Në datën 7.3.2022, kërkuësja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 7, datë 16.12.2021, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim nga një tjetër trup gjykues i Gjykatës së Lartë (*kërkesa nr. 2*).

11. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 57, datë 20.5.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, bazuar në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 31/a të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas së cilës Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës vlerësoi se për pretendimet e paraqitura Gjykata kishte dhënë përgjigje. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Mbledhja e Gjyqtarëve evidentoi se vendimi i kundërshtuar, ndonëse përbënte rrethanë të re, duke qenë se ishte dhënë pas vendimit të kësaj Gjykate, ishte konsideruar se nuk përbënte shkak që ankimi kushtetues individual i ri të kalonte për shqyrtim në seancë plenare. Sipas Mbledhjes së Gjyqtarëve, kërkuësja nuk ka paraqitur ndonjë argument që të tregonte ndryshimin e situatës dhe të interesit të saj nga koha e dhënies së vendimit nr. 34, datë 1.11.2021, nga kjo Gjykatë. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka çmuar se në rastin konkret nuk ekziston ndonjë fakt ose rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit të mëparshëm të Gjykatës, me rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet në themel të vendimmarrjes së mëparshme të saj.

12. Në datën 25.4.2024, kërkuësja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë të re për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë, ku, ndër të tjera, ka kërkuar edhe konstatimin e statusit të viktimës gjatë procesit gjyqësor dhe shpërblimin e dëmit, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Me shkresën nr. 2087/1 prot., datë 3.5.2024, “Për plotësim kërkesë”, kancelari i Gjykatës së Lartë e ka njoftuar kërkuësen se kërkesa e saj nuk ishte nënshkruar nga një avokat përfaqësues dhe e ka kthyer atë për plotësimin e të metave brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni të shkresës. Në datën 8.5.2024, kërkuësja ka paraqitur shkresën nr. 2289, datë 8.5.2024, “Kthim përgjigje” dhe bashkëlidhur saj ka dërguar edhe autorizimin e datës 7.5.2024, të administratorit të saj për caktimin e përfaqësuesit ligjor përpara Gjykatës së Lartë. Në të njëjtën datë kërkuësja ka paraqitur në atë gjykatë një kërkesë me të njëjtin objekt dhe përmbajtje si ajo e datës 25.4.2024, të nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërkohë që në të rezulton emri i përfaqësuesit ligjor të saj, por jo nënshkrimi i tij. Kërkesa është regjistruar me nr. 2289 regjistri, datë regjistrimi 8.5.2024.

13. Ndërkohë që kërkesa ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, kërkuësja i është drejtuar përsëri Gjykatës, duke paraqitur ankimin kushtetues individual, objekt shqyrtimi, i cili është regjistruar në datën 27.5.2024 (*kërkesa nr. 3*).

14. Pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2292, datë 30.5.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, me argumentin se mosveprimi i asaj gjykate nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e procesit ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator. Për më tepër, ai kolegji ka evidentuar se çështja e kërkuësës nuk përfshihet në

rastet e parashikuara nga vendimi nr. 178, datë 30.5.2019, i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” dhe se kërkesja nuk ka sjellë asnjë argument nëse çështja konkrete paraqet ndonjë specifike ose rrethanë të veçantë që të justifikojë shqyrtimin e saj me përparësi, jashtë rendit kronologjik. Ndërkohë ka sqaruar se Kolegji Civil ka filluar të shqyrtojë çështjet e regjistruara në vitin 2016 dhe se në vijim do të shqyrtohet edhe çështja objekt kërkesë, sipas rendit kronologjik.

15. Gjykata, me vendimin nr. 80, datë 21.11.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës nr. 3 bazuar në nenin 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës për mosformim të shumicës prej 5 gjyqtarësh. Sipas njërit qëndrim, kërkesa duhej pranuar, pasi koha e gjykimit të çështjes së kërkesës ka qenë thelbësore në drejtim të njohjes dhe ushtrimit të së drejtës së pretenduar nga ajo, ndaj tejzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Lartë ka bërë që pretendimet e saj, edhe nëse njihen gjyqësisht, të mbeten pa vlerë. Në këtë kuptim, çështja ka tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues. Sipas qëndrimit tjetër, kërkesa duhej rrëzuar, pasi, nuk ka rezultuar që kërkesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur, për të cilat pretendon se kanë shkaktuar moslidhjen në vijimësi të kontratave të mëtejshme të shërbimit. Në këtë kuptim, edhe pse ka një tejzgjatje të procesit, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkesës, numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t’u gjykuar, si dhe faktin se ajo gjykatë ka planifikuar shqyrtimin në dhomën e këshillimit të saj, nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

16. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4933, datë 27.11.2024, ka gjykuar themelin e çështjes duke vendosur mospranimin e rekursit, pasi ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Ndaj këtij vendimi kërkesja ka ushtruar ankim kushtetues individual dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 162, datë 19.6.2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

17. Për vendimin nr. 80, datë 21.11.2024, të Gjykatës, kërkesja ka paraqitur ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në datën 27.5.2025, GJEDNJ-ja ka marrë vendim për çështjen e kërkesit dhe për disa çështje të tjera (kërkesat nr. 39860/19 dhe 3 të tjera), botuar në Fletoren Zyrtare nr. 163, datë 15.9.2025, duke vendosur se në këtë rast është shkelur neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, duke gjetur shkelje të afatit të arsyeshëm dhe duke i akorduar edhe dëmshpërblimin përkatës.

18. Në datën 15.10.2025, kërkesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, në datën 23.12.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. **Kërkesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar se referuar vendimit të GJEDNJ-së në çështjen ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës, duhet të shfuqizohen vendimet nr. 34, datë 1.11.2021, nr. 57, datë 20.5.2022 dhe nr. 80, datë 21.11.2024, të Gjykatës, duke rihapur procesin. Gjithashtu, Gjykata duhet të konstatojë statusin “viktimë” përgjatë procesit gjyqësor si pasojë dhe rrjedhojë direkte e shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar më ligj dhe afatit të arsyeshëm në përputhje me çështjen “*Scordino kundër Italisë*”. Gjithashtu, Gjykata duhet të vendosë rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin, për shkak të vendimmarrjes së saj.

20. **Subjektet e interesuara, BKT-ja dhe KESH-i**, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuases

21. Referuar nenit 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës, nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare (pika 3). Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit (pika 4).

22. Për sa i takon çështjes së legjitimitimit (*locus standi*), si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues, ajo nuk përjashtohet në rastin e rihapjes së procesit sipas nenit 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës, duke verifikuar plotësimin e kriterëve ligjore për paraqitjen e një kërkeje të tillë.

23. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, pasi ajo ka qenë pala që ka vënë në lëvizje procesin kushtetues në përfundim të të cilit është dhënë vendimi i GJEDNJ-së në të cilin është gjetur shkelja e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

24. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis* sipas nenit 71/c, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i GJEDNJ-së është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 163, datë 15.9.2025, kurse kërkesa për rihapjen e procesit është paraqitur në Gjykatë në datën 15.10.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

25. Në këndvështrim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuësja ka pretenduar se referuar vendimit të GJEDNJ-së në çështjen ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës, duhet të shfuqizohen vendimet nr. 34, datë 1.11.2021, nr. 57, datë 20.5.2022 dhe nr. 80, datë 21.11.2024, të Gjykatës, duke rihapur procesin. Gjithashtu, Gjykata duhet të konstatojë statusin “viktimë” përgjatë procesit gjyqësor si pasojë dhe rrjedhojë direkte e shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar më ligj dhe afatit të arsyeshëm në përputhje me çështjen “*Scordino kundër Italisë*”. Gjithashtu, Gjykata duhet të vendosë rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin, për shkak të vendimmarrjes së saj, ndërkohë që subjektet e interesuara nuk kanë paraqitur prapësime.

26. Për sa i përket procesit gjyqësor që ka shqyrtuar kërkesën për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se kërkuësja ka vënë edhe më parë në lëvizje juridiksionin kushtetues për këtë qëllim dhe në vijim i është drejtuar GJEDNJ-së, duke pretenduar cenimin e neneve 6, pika 1, dhe 13 të KEDNJ-së për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të proceseve gjyqësore ku ajo është palë (kërkesat nr. 39860/19 dhe nr. 38996/20, ku e para i përket procesit gjyqësor në shqyrtim). Këto dy kërkesa janë bashkuar edhe me dy kërkesa të tjera kundër shtetit shqiptar dhe në përfundim GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 27.5.2025, ka vendosur se ka pasur shkelje të neneve 6, paragrafi 1, dhe 13 të KEDNJ-së. Po kështu, Gjykata konstaton se në zbatim të nenit 41 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja, në lidhje me kërkesën nr. 38996/19, i ka njohur kërkueses dëmin jopasuror në vlerën 3,300 euro dhe kostot e shpenzimit në vlerën 1,500 euro, ndërkohë që për dëmin pasuror të pretenduar ka vlerësuar se nuk ka gjetur ndonjë lidhje rastësore midis saj dhe shkeljeve të konstatuara.

27. Në këto kushte, bazuar në nenin 71/c, pika 5, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, kjo e fundit do të verifikojë nëse GJEDNJ-ja ka kërkuar zbatimin e ndonjë mjeti të veçantë korrigjues në vendimin e saj.

28. Referuar vendimit të GJEDNJ-së, në paragrafët 189 dhe 190 përcaktohet se nëpërmjet nenit 46 Palët Kontraktuese të Larta kanë marrë përsipër të respektojnë vendimet përfundimtare të Gjykatës për çdo çështje në të cilën ato janë palë, ekzekutimi i të cilave mbikëqyret nga

Komiteti i Ministrave. Rezulton *inter alia* se një vendim në të cilin Gjykata konstaton një shkelje, ushtron një detyrim ligjor ndaj shtetit të paditur jo vetëm t'u paguajë palëve përkatëse shumat e akorduara për shpërblim të drejtë sipas nenit 41, por edhe të përzgjedhë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme, dhe/ose, nëse është me vend, individuale që duhet të miratohen në rendin e tij ligjor vendas për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar sa të jetë e mundur efektet. Nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, shteti i paditur ka lirinë të zgjedhë mjetin me anë të cilit do të përmbushë detyrimin e tij ligjor sipas nenit 46 të Konventës, nëse këto mjete janë të pajtueshme me përfundimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës (*shih midis autoriteteve të tjerë, Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [DHM], nr. 39221/98 dhe 41963/98, §249, GJEDNJ 2000-VIII; Bronioëski kundër Polonisë [DHM], nr. 31443/96, §192, GJEDNJ 2004-V; dhe Stanev kundër Bullgarisë [DHM], nr. 36760/06, §254, GJEDNJ 2012, të gjithë me referenca të tjera*). GJEDNJ-ja mban qëndrimin se me këndvështrimin për të ndihmuar shtetin e paditur të përmbushë detyrimet e tij, sipas nenit 46, Gjykata mund të kërkojë të përcaktohet lloji i masave individuale dhe/ose të përgjithshme që janë konstatuar, që mund të merren për t'i dhënë fund situatës së papajtueshme me Konventën. (*shih Bronioëski, cituar më sipër, §194; Scoppola kundër Italisë (nr. 2) [DHM], nr. 10249/03, §148, 17 shtator 2009; dhe Stanev, cituar më sipër, §255*).

29. Duke marrë në analizë pretendimet e kërkuases në raport me vendimin e GJEDNJ-së, për pjesën që lidhet me atë, Gjykata çmon se shqyrtimi i këtyre kërtimeve nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të saj, për sa kohë që me vendimin e GJEDNJ-së jo vetëm është konstatuar shkelja e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, por është njohur edhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga ajo vonesë, çka është edhe qëllimi që ka synuar kërkuësja përmes këtij ankimi kushtetues individual.

30. Ndërkohë, Gjykata konstaton që masat e propozuara nga GJEDNJ-ja (*shih paragrafët 191 dhe 192 të vendimit të GJEDNJ-së*) nuk kanë përmendur ndonjë mjet të veçantë korrigjues, por kanë theksuar në terma të përgjithshëm problematikën ekzistuese, masat e përgjithshme që janë ndërmarrë tashmë dhe që duhet të vijojnë të ndërmerren nga shteti për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe shkeljen e afatit të arsyeshëm në gjykim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuësja nuk legjitimohet për këtë kërkim.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa është e pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj ajo rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 2.6.2026.

Shpallur më 9.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska,
Sandër Beci, Asim Vokshi